



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 63

Datë: 14.11. 2017, ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.62/2017;
 2. Raport nga SKQZ;
 3. Vendim për rinumërimin sipas vendimit të PZAP-it;
 4. Raport i Këshillave të KQZ-së;
Këshilli për Operacione Zgjedhore;
Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për ditën e zgjedhjeve
Shqyrtimi dhe miratimi i KVV-ve për Partesh;
 5. Të ndryshme
-

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.62/2017

Valdete Daka: Përshëndetje. Mirë se keni ardhur në mbledhjen 63 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve! A ka dikush diçka për me shtuar në rendin e ditës? Nëse jo, atëherë kush është për rend të ditës?

Anëtarët e KQZ –së miratuan rendin e ditës.

Valdete Daka: Vazhdojmë pra me piken e parë: Miratimi i proces verbalit të mbledhjes së 62/2017. A ka dikush vërejtje për këtë procesverbal? Kush është për miratimin e këtij procesverbali?

Valdete Daka: Faleminderit! Vazhdojmë për piken e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.62/2017.

Anëtarët e KQZ-së miratuan procesverbalin nr. 62/2017.

2. Raport nga SKQZ

Enis Halimi: Sekretariati, ka vijuar për përmbushjen e detyrave konform të planeve tona, me në funksion të realizimit të raundit të dytë të zgjedhjeve lokale. Për sa i takon shërbimit votues të listës përfundimtare të raundit të dytë të komunave, janë shtypur edhe janë kontrolluar listat e votuesve dhe po ashtu është bërë shtypja e listës përfundimtare të votuesve në komunën e Parteshit do të bëhet ri përsëritja ku do të ketë rivotim gjithashtu procesi i shtypjes ka përfunduar me datën 9 dhe lista votuese është në depon tonë. Kjo në raundit e dytë të zgjedhjeve, do të mund të votojnë 6847 mijë votues në të cilat mund të votojnë në raundin e dytë të cilat u prezantojmë në tabelën numër 2 i shpërndarë sipas komunave divizioni përkatës për krijimin e listës votuese për themelimin e pakove të fletëvotimit që këta votues janë të regjistruar suksesshëm dhe po ashtu janë përmes emailit janë njoftuar mbi 4 mijë 500 votues ku janë dërguar informatat dhe të fletëvotimit për kryetar, ndërsa sa i përket pranimit të materialit ne i kemi pranuar deri me datën 13 me 400 pako të supozuara të cilat mund të ketë fletëvotime për zgjedhjet lokale të datës 22 tetor që janë dërguar dhe kanë arritur me vonesë në faunën tonë, kapë për numrin e saktë të fletëvotimit për raundin e dytë fillon me datën 19 të procedimit.

Po ashtu, tha z. Halimi, edhe për votues edhe për nevoja të veçanta i keni në tabelën nr. 1 dhe për sa i takon kësaj në faqen numër 3, dhe po ashtu edhe në faqen numër 4 për votues me lëvizje të kufizuar dhe në faqen numër 5 edhe votuesit me rrethana të veçanta për sa i takon pranimit janë zhvilluar 330 seanca pranimi me gjithsej 9 mijë 339 vijues në këtë trajnim në qendrën e numërimit të rezultateve vijojnë aktivitet që kanë të bëjnë me raundin e dytë e që përfshin me trajnimin të personelit dhe po ashtu pika që lidhet deri në piken e dytë do ta konsumojnë tash, teknologjia informative përgatitjet që kanë të bëjnë me përfshinë në këtë fushë për sikurse e dini shtypja dhe tash më votimet janë rrugës duke ardhur për edhe materiali tjetër jo sensibil ka filluar që të paktohet të shpërndahet komfort planeve tash me arritjen e materialit senzitiv të procedurave të zakonshme edhe të behet procedimi i ti,

Valdete Daka: Faleminderit, Krye shef! Kush e dëshiron fjalën...?

Betim Gjoshi: Krye shef, ndoshta je në dijeni: në një palë zgjedhje, të paktën votimi i personave nëpër institucione ka shkuar huq si operacion. Po na sillni raporte të mira por, si operacion ka dështuar. Të gjitha votat e këtij shërbimi, i kemi mashtruar edhe qytetarët e Kosovës që janë shpall të pavlefshme cilat janë masat prej raundit të parë në dytin mos m'u

përsëritë e njëjta. ose ndoshta se dini hiq këtë punë.

Enis Halimi: Normal që e dimë sepse në një proces të tillë të madh mund të ketë edhe keqkuptime, edhe lëshime të pa qëllimshme po e pame si përvjedhur, si një lëshim i tillë, do të thotë ka ndodhur por ne, tash këtë raund kemi marrë masa konkrete duke bërë identifikimin e të gjithë votuesve që janë nëpër këto institucione. Pra, kemi proceduar me dhënien e shënimeve të sakta për secilin këta votues të vendit që gjenden nëpër KKZ-të përkatës. Tash, nuk do të lejojmë që një lëshim i tillë ta na përhidhet prapë. Kemi marrë gjitha masa të tjera. Pra, ne jemi të mobilizuar që çdo votë të shkojë aty për ku është e dedikuar, pra jemi në ngjarje të këtyre problemeve që i kemi pas gjatë zgjedhjeve. Nuk kemi ndenjur duarkryq, por kemi proceduar në kuptim të zgjidhjes së kësaj çështje në mënyrë edhe një herë përsërisht votuesi ta dërgoj votën aty ku e dedikon.

Betim Gjoshi: Por, pse nuk e keni pa të arsyeshme as me na informuar KQZ-në për këto probleme, e para...? E dyta, a e keni raportuar në KQZ se janë shfaqur njerëz që janë regjistruar jashtë vendit, dhe që jetojnë në Kosovë por, që janë në listë votuese jashtë vendit?

Adnan Rrustemi: Dua me shpreh një shqetësim që sa i përket votimi jashtë vendit, sidomos kam disa raste të konfirmuara për cila jam duke i përgatitë edhe mbledhë materialet për një shqetësim si në zgjedhjet e 2009 dhe të 2010 aplikacionet që kanë ardhur nga Mali i Zi për regjistrimin si votues jashtë vendit. Nuk e kam aspak lidhur me ndikimin në rezultat, e kam me veprën penale që ka ndodhë: janë regjistruar njerëz që janë shtetas të Kosovës që jetojnë në Kosovë që s'kanë qenë jashtë. Janë dërguar aplikacionet me atashimet, rrjedhimisht u bë dëmi i dyfishtë. Në njërin anë, është keqpërdor e drejta e tyre, dhe në anën tjetër ja kemi pamundësi votimi e rregullt në vendvotim i kemi largu listën votues jashtë Kosovës. Unë kam pranuar këso raste. I kam shkruar edhe shërbimit votues edhe krye shefi, kam kërkuar prova, aplikacioni dokumenti se çka ka ndodhë se mora vesh nga Istogu janë raportuar disa raste jo vetëm një i mbledhë këto raste që i ka raportuar edhe KKZ-ja edhe me njoftuar policinë edhe prokurorinë edhe me hetuar si të themi rrugëtimi i këtyre aplikacioneve me pa se çka ka ndodhë kush i ka falsifikuar edhe me marrë masa se ky është njëfarë, nuk po hezitoj me quajt një, krim i organizuar.

Nuk e kam fjalën për ndikimin në rezultat, tha z. Rrustemi. Është çështje që na e kemi certifikuar, s'kemi çka bëjmë, çështja është me gjithë atë nuk duam të rrimë duarkryq edhe duhet me adresuar menjëherë sekretariatit edhe policinë edhe raste që janë raportuar në sekretariat që kam informuar edhe le të hetohet. Ndërsa sa i përket, pajtona për persona në institucione a ka mundësi me na informuar qoftë me shkrim jo vetëm sot se çfarë masa konkrete, se qysh me ndodhë mu realizuar ky operacion se ka shumë të panjohura se përveç procedurës po e kuptoj përpjekjen si votues të rregullt gabimi ka qenë gabimi i par duhet me pranuar duhet me e evidentuar kam një shqetësim tjetër institucione. Paraburgimi ka votues si raundin e par nga krejt Kosova nga evidentuar nga komuna e tyre tash kemi vështirësi shtesë me i nda vete votuesit e komunave që janë në balotazh për meja dërguar materiale edhe me mundesh votimi e tyre si me thanë edhe ma vështirë se në raundin e par ne qoftë se është e mundur komplet njëfarë procedurën e votimi se qysh me ndodhë me regjistruar me votuar këta votues si procedohet në QNR dhe si i trajton QNR si me ndodhë

mos me na ndodh si me vota me kush nga një komunë tjetër veçanërisht me i shpall te pa vlefshme.

Betim Gjoshi: Kryetare, ne qoftë se bën...? Është mirë që dita e ditës po vijmë në përfundimet që i kam thanë gjithmonë që votimi jashtë vendit është i parregulluar është i pa mbrojtur edhe pajtohem edhe kam kërkuar që në të kaluarën me hetuar këtë proces, por nuk mundemi me nda në 2009-2010 me hetuar komplet. Se mendoj që edhe 11 qershor ka pasur raste të tilla ju kam paralajmëruar por nuk keni marr, subjekte politike që kanë organizuar këtë veprimtari të krimit të organizuar dhe e kam thanë edhe këtu që ekzistojnë edhe regjistrime se nuk ka qenë vullneti i votuesve edhe kjo është keq. Ne, duhet me menduar që me lejuar që votuesit e Kosovës që jetojnë jashtë vendit por me votuar vet ata, nuk ka votim kolektiv sepse është i ndaluar edhe me ligj po të paktë që këto zgjedhje le ti marrin masat e duhura që secila votë me u numëruar dhe me u tregu vullneti i qytetarëve ton.

Enis Halimi: Ne, do të përgatisim raporte dhe do ju informojmë përmes e-mailit për procedurën dhe masat që kemi marr konkrete, edhe njëherë po themi të vendosim brenda mundësive që i kemi tona për ta korrigjuar dhe rregulluar këtë akses.

Betim Gjoshi: Po e presim me padurim me përfunduar në mënyrën më të mirë gara e balotazhit me 19 nëntor se ka me na informuar krye shefi për shumë fenomene të cilat i ka mbajtur të mbyllura dhe nuk ka pasur transparencë. Sikurse këto dy raste që u ngritën dhe nuk jemi njoftuar zyrtarisht por po duhet mi marr informatat në rrugë e jo zyrtare. Ka edhe shumë të tjera prej personelit në mënyrë enorme nga zgjedhjet e përgjithshme, tejkalim të vendimeve të KQZ-së pa asnjë arsytim ku dihet që në zgjedhjet lokale janë shkurtuar shërbimet edhe ka qenë mundësia më e madhe me ju qas afat për shumë çështje të tilla, që me siguri në ditët në vazhdim do të përgjigjet para KQZ-së.

Valdete Daka: Edhe unë e kam një pyetje për krye shefin. E ajo është puna e shpalljes së rezultateve natën e zgjedhjeve , pas përfundimit të zgjedhjeve që kemi pasur një problem me operatorin. A janë marr masat që këtë herë mos të na ndodh kjo dhe që publiku ti ketë. Sepse përfundimi i gjitha zgjedhjeve janë rezultatet dhe gjithë puna e mirë shkon damë edhe kot qoftë se nuk publikohen rezultatet reale. A janë ndërmarr masat që me operatorin, shërbimin informativ at natë të transmetohet ashtu siç i kemi transmetuar gjithmonë?

Enis Halimi: Po, kemi analizuar shkaqet dhe kemi ardhur në përfundimet tona. Sot, e kemi një takim në ora 2 me operatorin përkatës aty do ti diskutojmë gjitha për ndoshta çka ka qenë në këtë fazë. Do të diskutojmë për atë që do të jetë në balotazh, për të mos përjashtuar edhe masat e tjera që do ti marrin ne raport me operatorin në kohë të tjera kur përfundon në afat. Ndërsa sot në ora dy është takimi për raundin e dytë.

Sami Hamiti: Desha të ndërlihem me këtë që e thatë ju me operatorin. Kemi tri raste, ose po dështon operatori ose po dështojmë ne si KQZ. Ka dështuar paraqitja e rezultateve në zgjedhjet nacionale, kemi mbetur këtu deri në ora 11 pse ka ndodh, çka ka ndodhur. Ajo është çështja pse po na ndodh ditën kur duhet, procesi shkon për mrekulli deri në fund dhe nuk ka rezultate, në fund na ka ndodh me 22, kemi mbetur gjithë ditën ka qenë në kuptimin e organizimit të zgjedhjeve dhe nëpër vendvotime, besoj në bazë të asaj që kemi marr prej dhomës operative me më së paku probleme që kanë ndodhur në mbrëmje dhe të gjithë portalet dhe televizionet i qesin rezultatet dhe KQZ-ja nuk ka rezultate. Mbetet tash se, a

kanë me ndërruar në sistem është çështje, unë mendoj që me operatorin tri here radhazi po na bën probleme dhe herën e fundit kemi pasur probleme sepse ditën që është dashur mu shpall rezultatet përfundimtare, tërë ditën kanë punuar pjesa e IT-së me gjet zgjidhje alternative me atë fazë, nuk kemi problem. Pse po na ndodh gjithmonë me 11 nëntor me 22 na ndodhi me 9 kur i shpallëm na ndodhi. Në këtë rast me operatorin thjesht unë mendoj që për pjesën e asaj dite kanë bërë, asesi mos t'ju bëhet pagesa. Kemi dalë qesharak në ora 1 kanë dalë rezultatet, gjitha gazetat dhe portalet i kanë pasur.

Betim Gjoshi: Për mos me rënduar më shumë mbledhjen. Edhe dy çështje të vogla i kam. E para sa i përket kolegëve që u deklaruan pajtohem komplet edhe unë mendoj që mos pagesa është dëmi më i vogël, na duhet me kërkuar dëmshpërblim për humbje të imazhit seriozitetit të institucionit se na e kemi përfunduar punën tonë, i kemi pas rezultatet dhe s'kemi mujtë me i'u afruar publikut, dhe kjo na ka dëmtuar, na e dimë që në disa parë zgjedhje kemi qenë pike referuese edhe për media edhe për gjithë rezultatet tona kane qenë të parët, e dyta se di a jeni ne dijeni, për shembull, këtë vazhden e mos transparencës prej shteteve të Kosovës te caktuara bëhen transport për vetëm qysh bëhen në mënyrë jo të drejtë, punësim prej qyteteve të caktuara organizohet edhe transport me kërkesën tonë nga organizata OSBE për segmente të caktuara te punëtoreve, na se kemi provuar as nuk e ka tejkaluar këtu mendoj që dhe në ditët në vazhdim kemi jashtëzakonisht punë me këto që ka ndodh në institucionin tonë, faleminderit.

3.Vendim për rinumërimin sipas vendimit të PZAP-it

Valdete Daka: Faleminderit! po shihet që kemi shumë çështje me i diskutuar me shefin në ditët në vazhdim. Vazhdojmë me pikën tjetër ajo është vendim për rinumërim sipas vendimit të PZAP-it. Siç e dini na dje i kemi pranuar vendimet e PZAP-ës lidhur me ankesat e kandidatëve pas shpalljes të rezultateve të përfundimtar dhe si pasoj e këtyre vendimeve ne sot duhet t'i ri numërojmë 440 kuti ku PZAP-ja ka gjetur se ka arsye te pranimit të ankesave të këtyre kandidatëve, ju i keni para jush të tabelën me të gjitha vendvotimet të cilat PZAP ka marrë vendim që të rinumërohen vetëm desha me ju informuar që dhe në mesin e tyre janë dhe 70 kuti të cilat vetëm janë rinumëruar me vendim tonin dhe është për keqardhje që PZAP-ja nuk i ka shikuar atë listë që ne ja kemi dërguar me kutit e rinumëruara pra janë edhe 70 të cilat pra janë rinumëruar.

Betim Gjoshi: Faleminderit, e nderuar kryetare! Unë edhe pse ky vendim i vonuar i PZAPI-it jashtë gjithë afateve mu më ka gëzuar jashtëzakonisht shumë. Unë kam qenë ithtar edhe jam ithtar rinumërimit të të gjitha kutive të qendrave të votimit dhe të rezultateve. Ka pasur shqetësime nga kandidatët për asamblist i të gjitha subjekteve dhe të gjitha nacionaliteteve dhe për këtë mendoj që si Komision Qendror Zgjedhor duhet me qu vullnetin e qytetarëve në vend edhe me ja u dërguar një mesazh Këshillave të vendvotimit që ne pa marrë parasysh tendencat e tyre me keqpërdorë procesin në gjatë gjithë zgjedhjeve do të mundohemi ta qojmë vullnetin e qytetarëve në vend. Unë në këtë rast d.m.th. këto 441 kuti që neve na ka sjell PZAP-i edhe ato që janë rinumëruar kisha kërkuar nga të gjithë anëtarët e Komisionit Qendror Zgjedhor që me marrë vendim me rinumërua për të gjitha subjektet politike për të gjithë konditat jo vetëm për kandidatët përkatës për arsye se

procedurat Qendrës së Numërimit të Rezultateve nuk ofrojnë mundësi të tilla edhe në mund të vijmë në një situatë kur ka edhe vota për kandidatë të tjerë që mund të mos jenë të sakta.

Edhe këto, sa janë 71 kuti, tha z. Gjoshi kisha dashur me i rinumërua edhe me na sjell dy parë procesverbalet me i pa se edhe punëtori në QNR-ë a po numërojnë si duhet. Pse kur të kem parasysh d.m.th., që kanë keq përdorë në vendvotim nuk ma heq dyshimin që njerëz të njëjta janë edhe këta të qendrës së numërimit dhe rezultateve që të paktën me marr masa ndaj tyre bile ndaj këtyre të QNR-ës edhe ma rigoroze. Është e pakuptimte nëse çfarëdo vendimi për rinumërim të pjesshëm unë e di që na hup nja 4 ditë rinumërimi i këtyre por, është shumë më mirë që ne sado pak d.m.th., ta korrigjojmë po i bije që mbi 50% vendvotimeve ose rreth tyre po numërohen. Kjo, besoj që ka m'i ndihmuar jashtëzakonisht procesit edhe në të ardhmen që, nëse mbetet sistemi zgjedhor komisionarët me pas kujdes në numërim se, kur janë zgjedhjet nacionale përnjëmend ka shumë kandidat edhe shumë subjekte e vota preferenciale për 5 vetë por, kësaj radhe ka qenë një votë - një kandidat. Është e arsyeshme me pas mospërputhje dhe mos me pas probleme në rinumërim por, këto janë kryesisht raste të qëllimshme d.m.th., edhe për këtë unë e përkrahi që m'u ri numëruar këto 440 kuti. Kisha kërkuar diçka shtesë, që mos ta marrë fjalën për së dyti! Kisha pas dëshirë që me b'a një orar të saktë kur numërohet secila kuti, dhe me ju ofruar kandidatëve të cilët kanë ankimi ku janë kutitë e tyre për m'u numëruar, e ata me aradhe e me e pa rinumërimin se, kështu edhe e bajame transparent procesin. Sigurisht, edhe vëzhguesve që e kanë të lejuara ka 6, sa e kanë subjektet politike ose edhe nga 10, sa e kanë të lejuar aq sa e kemi rritë numrin herën e fundit. Faleminderit...

Valdete Daka: Gjithsesi kjo do të jetë me interes për vetë kandidat që të vijnë edhe shohim edhe me QNR-ën a mundemi me i kontaktua ata zyra i ka numrat kontaktuese edhe të kandidatëve le ti kontaktojnë ata që janë të interesuar procesi është transparent edhe publik për të gjithë ata që janë të interesuar edhe që janë të akredituar. Po urdhëro Sami....?

Sami Hamiti: Faleminderit. Unë e përkrahi Betimin në kuptimin e asaj që problemi i aprovimit të atyre ankesave që kanë ardhur nga PZAP-i edhe kandidatëve që të ju hiqet merak i fundit edhe të bëhet rinumërimi në qendrën e numërimeve ata 440 kuti por me gjithë atë më duhet të them çështjen e atyre 70 kuti të rinumëruara që ka ardhur si kërkesë prapë, ok le të rinumërohen por është qesharake që PZAP-i me gjithë se ka marr shkresën prapë i fut në rinumërim ok, le të bëhen edhe ato krahasime e dimë mirë çka ka ndodh në zgjedhjet nacionale jo me rinumërua 2 herë 3 herë kutit me vendime të posaçme ndamë prej një subjektit të tjetri edhe pse janë rinumërua kostoja, ki me bo një kosto të veçante për nja 30 kompani që janë rinumërua nja 2-3 herë, rezultati ka qenë 0 d.m.th. kurse ndryshimi, kurse nja 2-3 mijë euro kanë kushtuar buxhetit rinumërimi i atyre kutive.

Prandaj, tha z. Hamiti, është qesharake edhe një herë po them që PZAP-i nuk vijnë nuk sheh e kam thënë edhe një herë po e them prapë që krejt rajonin në Evropë shkojnë vëzhgojnë zgjedhje ndërsa nuk vijnë në qendër të votimit me përcjell si bëhet rinumërimi i kutive apo të jenë prezent kur të bëhet ai rinumërim. Ndoshta futen tash edhe 70 kuti, ok unë do ta votoj që edhe ato të rinumërohen edhe pajtohem që të rinumërohen jo vetëm për kandidat po komplet kutia për të gjitha subjektet. Por, me gjithë ata PZAP-ja ët jetë, ok 70 kuti po rinumërohen unë në bazë të përvojës herën tjetër ju them që diferenca apo do të jetë në promila që nuk ndryshon bash asgjë kurse na bënë koston në buxhetin e Kosovës.

Binak Vishaj: Pa filluar ajo periudha e ankesave këtu në mbledhje të KQZ-ës e kemi thënë sa e nevojshme është që paneli zgjedhor të vijë ta vëzhgojnë të gjithë procesin e rinumërimit në qendër të numërimit edhe ta kenë një pasqyrë të qartë krejt rezultatet që ndodhen atje pas rinumërimit. Megjithatë ata nuk kanë gjetur kohë ose nuk e kanë par të arsyeshme ne duhet ta respektojmë vendimin e tyre në plotni ashtu qysh ata e kanë vendos. Më shumë për faktin sepse këto 71 kuti po donë me pa se a është njëjtë si me tri si me këshillat e vendvotimit donë me pa sa të saktë e kemi një që e kemi angazhua në qendrën e numërimit edhe uroj që të del rezultatit ashtu siç ka ndodh në rinumërim mos të del rezultat tjetër sepse ata njerëz janë të evidentuar edhe atëherë jam që masat ndaj tyre janë më të rrepta të paktën në qendër të numërimit mos të na ndodh që të mos ketë devijim të besimit gjatë rinumërimit. Ndërsa për pjesën e vëzhgimit të kandidatëve është mirë m'i lajmërua partitë politike mi thonë që kanë të drejtë edhe kandidat ankues me qenë prezent në ditën kur rinumërohen kutit për të cilat ata janë ankuar në rast se ata vijë në rast se jo partia ta ketë këtë informacion dhe ti njoftojë kandidat se ka kandidat që ose nuk mundet me ardhur ose ka ndonjë arsye tjetër por, partia ta ka si informacion që mundet edhe kandidat me qenë pjesë e vëzhgimit për kutit e veta të cilat ja u ka miratua paneli zgjedhor, edhe numërohen sipas planit në qendër të numërimit.

Eshref Vishi: Faleminderit kryetare, e përkrahë propozimin e kolegëve për rinumërim të kutive në bazë të vendimeve të PZAP-it që rinumërimi vetëm për ankuesin e një subjekti politik, mirëpo për të gjitha subjektet politike. Nga ky proces dhe përvoja e praktika që kemi pas në zgjedhje, shihet qartë se faktikisht sistemi zgjedhor ka dështuar në procesin e votimeve dhe të numërimit të votave. Me kërkesë të QNR-së janë rinumërua afër 700 kuti, përkatësisht 695, tani edhe 440 të tjera, d.m.th, del se 40% të kutive në nivel të Kosovës po rinumërohen. Ky është edhe një sinjal që Kosova gjegjësisht, Kuvendi i Kosovës duhet ta ketë parasysh reformën zgjedhore. Me këtë reformë zgjedhore, besoj që do të jemi më rezultativ dhe të suksesshëm në kuptim të integritetit të procesit zgjedhor në zgjedhjet pasuese...

Ilir Gashi: Faleminderit kryetare Ajo çka dua të them është se nevoja faktikisht nga vendimet e PZAP-it që patjetër ne duhet ti respektojmë por, kjo tregon qartë domosdoshmërinë që subjektet politike sidomos ato ndryshime në Kuvendin e Kosovës t'i kyçen shpejt dhe në mënyrë efikase ose një reforme të domosdoshme zgjedhore. Mirëpo opinioni publik edhe vetë partitë duhet ta dinë që këto probleme po sillen kryekëput nga njerëzit e tyre të involvuar në proces zgjedhor sepse ne si Komision i kemi organizuar zgjedhjet në mënyrë ma të mirë të mundshme por, kur po vjen puna që ky proces po bie në duar të subjekteve politike atëherë po vjen ky rezultat ne sot duhet ti rinumërojmë më shumë se 400 kuti apo vendvotime.

Prandaj, tha z. Gashi, kjo duhet të trajtohet me sinqeritet dhe seriozitet edhe nga subjektet politike por, edhe nga shoqëria civile që sa më parë ti kyçen një reforme zgjedhore sepse ky sistem kështu siç është, është e pamundshme që edhe në të ardhmen të ketë përmirësime sepse njerëzit e subjekteve politike të kyçur në proces po manipulohen dhe po na sjellin në problematika të tilla të cilat më pastaj edhe po e degradojnë gjithë procesin. Edhe unë pajtohem patjetër që edhe ata 70 kuti të rinumërohen në mënyrë se siç u tha ndoshta edhe mund të nxjerrën diçka më tepër se sa që i ka dal nga rinumërimi paraprak dhe natyrisht që kërkoj që të gjitha këto vendvotime të cilat PZAP-i ka marr vendim mbas rinumërimit të

identifikohen dhe të bëhen objekt trajtimit të prokurores dhe gjykatave në mënyrë që ky sistem që të trajtohet faktikisht këta njerëz të trajtohen si manipulues të gjithë procesit.

Valdete Daka: Faleminderit mbi te gjitha vend votime ku ka rezultuar se rezultatet janë ndryshe nga ato që janë rinumëruar në vendvotime, gjithsesi duhet të dërgohen në emrat e gjithë komisionarëve edhe në prokuroritë përkatëse...

Adnan Rrustemi: Unë jam dakord që rinumërimi të jetë i tërësishëm, pavarësisht nga ankesat që janë individuale të kandidatëve në fjalë. Natyrisht, sado pak, do të mundohemi me e përmisuar procesin dhe me qenë sa ma transparent. Secilit kandidat, rrjedhimisht mundemi me ia siguruar rinumërimin. Jam dakord po ashtu, padyshim, me u rinumëruar edhe 70 kutitë që ne, veç i kemi rinumëruar. Po ashtu, kërkoj që edhe qendra me na sjell një raport me mospërputhjet. Uroj që të jen në përputhje të plotë po, në rastet se nuk do të ketë përputhje, ta shohim ku janë dallimet. Mendoj se duhet me marrë masa ndaj punëtoreve të QNR-s se, dhe se identifikimi i tyre është lehtë. Në anën tjetër, sa i përket vendimit për rinumërim nga PZAP-it, bëhet fjalë edhe për mënyrën e rinumërimin. Tashmë, unë të vetmin shqetësim e kam nëse PZAP, këto ankesa për këto 70 kuti, i ka pas para rinumërimin që e kemi bërë ne, që edhe mund t'i ketë pas! Vërtetë, mendoj se ka pas vend edhe për me e shmang vendimin e sotëm, por nëse vendimi i PZAP për këto 70 kuti ka të bëjë për dallime në mes të rinumërimin të QNR-s dhe votave në formular në vendvotime, atëherë unë jam dakord me i shkue në rinumërim...E kam theksuar edhe në mbledhjen e kaluar se, në vendvotime ka pas mospërputhje dhe dallime që duhet të na sillen nga QNR – ja. Të na sillen edhe lista e Komisionarëve dhe, ta adresojmë në Prokurori. Duhet t'i japim fund njëherë e përgjithmonë kjo situatë të marrë fund, dhe që të definohet si duhet vullneti i votuesve, përjashtuar gabimet teknike...

Valdete Daka: Burim, besoj që kryhet kjo punë... Faleminderit, mendoj që i adresum të gjitha shqetësimet tona, e besoj se pas rinumërimin t'i kemi emrat e komisionarëve ku ka pas ndryshime nga ku ka munguar vota në vendvotim edhe, që kanë dal pas numërimin, sepse po tregohet që është e pasuksesshme edhe krejt ajo çka kemi b'a në bashkëpunim me prokurori edhe polici, po tregohet se ka qenë e pasuksesshme. Ndërkaq, që rinumërimi fillon sot në ora 11, kështu që janë njoftuar me siguri edhe subjektet politike, edhe gjithë të tjerët...

4. Raport i Këshillave të KOZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit për Ditën e Zgjedhjeve

Betim Gjoshi: Po, në këshill për Operacione Zgjedhore, i kemi pas dy çështje: Plani për ditën e Zgjedhjeve. I vetmi ndryshim është se, komunat që e kanë krye balotazhin, Zyrtarët

Komunal Zgjedhorë do të jenë pjesë e ekipeve, dhe kjo është pjesa e mirë...! Pjesa tjetër, është e njëjta, do të thotë nuk ka ndryshim, është s'i herën e kaluar.. Kërkojë aprovimin tuaj...

Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan planin për Ditën e Zgjedhjeve

Valdete Daka: Jo, për vendimet e PZAP-së nuk kemi nevojë me votuar sepse, edhe PZAP na urdhëron dhe nuk e le në dëshirën tonë...Por, votojmë ne për QNR-n që të bëjë rinumërimin....! Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, urdhëruan QNR-në që të bëjë rinumërimin e kutive.

Valdete Daka: I kemi edhe KVVP edhe në Partesh

2. Shqyrtimi dhe miratimi i KVV-ve për Partesh

Betim Gjoshi: Këshillat e Vendvotimit i kemi për Komunën e Parteshit, duke e pasur parasysh se janë dy konditat në garë dhe, nuk ka pasur interesim nga OJQ-të dhe as nga subjektet e tjera...E kemi një formulë të Këshillave të Vendvotimit, dhe duke u bazuar edhe në nenin që KQZ-së ia bënë të mundur dhe i jep mundësi që t'i emërojë KVV-të...Edhe herën e kaluar kanë qenë të njëjtë dhe kërkojmë që KQZ t'i miratojë përbërjet e KVV-së...?

Anëtarët e KQZ-së miratuan KVV-të për Komunën e Parteshit në të cilën, më 19 nëntor 2017, do të rivotohet për Kryetar Komune.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
